




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës
duke u mbështetur në Vendimin për Kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve
nr. 01-091-112404 të dt. 12.05.2014, bën

THIRRJE

krijuesve për aplikim me projekt propozime për PRODHIM TË AUDIO INCIZIMEVE në fushën e MUZIKËS. Audio incizimi mund të jetë muzikë klasike, xhaz, muzikë rock dhe alternative. Aplikimi është i hapur vetëm për solistë dhe grupe muzikore.

Parakushti për aplikim është që veprat e krijuara të jenë të pa publikuara më heret.

Projekt propozimi duhet të plotësojë kërkesat si në vijim:

- Të plotësohet aplikacioni online (**krs.prishtinaonline.com**) duke dhënë informata të hollësishme rreth aplikuesit, projekt idesë dhe buxhetit të kërkuar;
- Të bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
 - Deklarata për autorësinë e veprave;
 - Deklarata për caktimin e përfaqësuesit të grupit muzikor, nëse aplikohet si grup;
 - Repertorin e veprave të cilat do të incizohen në 5 kopje (të shtypura apo/dhe demo incizimi);
 - Dëshmi për përvojë krijuese (fillestarët nuk kualifikohen);
 - Dëshmi të pjesëmarrjes solistike apo si grup në koncerte dhe festivale kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - Marrëveshje me studion e incizimit për realizimin e punës përfshirë kostot e incizimit, masterimit dhe të gjitha tatimeve të aplikueshme;
 - Planin e shpërndarjes së audio incizimit;
 - Dëshmi që krijuesit janë rezident të Komunës së Prishtinës;
 - Kopja e letërnjoftimit të solistit apo përfaqësuesit të grupit muzikor;
 - Vërtetimi bankar për llogarinë personale bankare të solistit apo përfaqësuesit ligjorë të grupit muzikor;
- Projekti të përmbillet deri me 31 dhjetor 2017;
- Aplikacioni i plotësuar të shtypet dhe së bashku me dokumentet e kërkuara, dhe kopjet e demo incizimit të veprave të dorëzohen në sportelin nr. 5 në ndërtesën e Komunës së vjetër.

Konkursi është i hapur deri me 19 shtator 2017 në orën 15:00.

Mbështetja financiare mbulon vetëm shpenzimet për incizim në studio dhe masterim. Shpenzimet tjera si ato administrative, honorarët për solist/ grupe muzikore, nuk do merren parasysh.

Për shkak të kufizimeve buxhetore dhe me qëllim të mbështetjes së numrit sa më të madh të kërkesave Komuna e Prishtinës rezervon të drejtën që projektet t'i përkrah me shumë më të vogël nga ajo e kërkuar, por edhe të i refuzojë në tërësi. Shuma maksimale e përkrahjes për një projekt është 1500 euro, ndërsa përzgjedhja e projekteve për mbështetje bëhet nga juria profesionale.

Autorisnë e produktit final e mbanë solisti apo grupi muzikor. Autori ka të drejtë përfitimi financiar nga shitja e veprës. Ndërsa Komuna e Prishtinës e ka të drejtën e shfrytëzimit për nevoja të veta dhe të palës së tretë për promovim dhe shpërndarje pa nevojë kompensimi shtesë të autorit. Çdo ndryshim dhe modifikim i projektit për shfrytëzim nga Komuna e Prishtinës duhet të bëhet në marrëveshje paraprake dhe aprovim të autorit.

VËREJTJE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës, si dhe projektet e palëve dhe grupeve muzikore të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga fazat paraprake nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Për çdo informatë shtesë ju lutem na kontaktoni në kultura.pr@rks-gov.net apo 038 226 417.